

Në
rrugën
e duhur!



Spot on.

NE JEMI SIGAL UNIQA

NE jemi kompania lider në tregun e sigurimeve në Shqipëri, ku udhëheqim tregun vendas që prej vitit 2003, duke zotëruar mesatarisht 30% të tregut.

Grupi SIGAL UNIQA është një familje e madhe që numëron mbi 1200 punonjës dhe agentë, të cilët u shërbejnë 500 mijë klientëve në tre shtete: Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni.

SIGAL UNIQA është ndër grupet më të mëdhenj financiarë në rajon, i përbërë nga 7 kompani sigurimesh dhe 1 fond pensioni privat dhe zotëron 121 milionë Euro asete, numëron 59.5 milionë Euro prime të shkruara për vitin 2017 dhe rreth 21 milionë Euro dëme të paguara.

PERMBLEDHJE

Të dhënat kryesore

Harta e shpërndarjes

Fjala e CEO-s së UNIQA

Fjala e Drejtorit të Përgjithshëm

Bordi i mbikëqyrjes i SIGAL

Vlerat dhe parimet

Ngjarjet kryesore

Përgjegjësia sociale

Inovacion

Tregu rajonal i sigurimeve


Të dhënat kryesore

Raporti i audituesit të pavarur


Kontakte

TE DHENAT KRYESORE


Volumi i primeve (Euro)




Nr. i zyrave



Nr. i kontratave



Agjentë dhe punonjës





Drejtoria e Përgjithshme
Tiranë, Shqipëri

GRUP RAJONAL SIGURIMESH

Regional Insurance Group

0.3 milion
klientë në Rusi

RU¹⁾
13

3.0 milionë
klientë në EQ

PL
9

CZ
5

SK
5

UA
1

3.6 milionë
klientë në Austri

AT
2

HU
8

RO
8

HR
7

BA
3

SRB
6

MNE
3

KO
2

BG
7

1.8 milionë
klientë në EJT

MK
6

AL
1

■ Europa Qendrore (EQ)

■ Europa Lindore (EL)

■ Europa Juglindore (EJT)

■ Rusia

Numri tregon pozicion në treg të secilit shtet.

¹⁾ Tregu i sigurimeve të jetës në Rusi.

Të nderuar zonja dhe zotërinj, Të nderuar partnerë,

Për tri arsye themelore, 2017-ta, vit që përkon me vitin e gjashtë të programit tonë strategjik UNIQA 2.0. ishte një vit i mirë për UNIQA Insurance Group AG, për arsyet që do ti mësoni më poshtë.

Së pari, ne kemi fuqizuar edhe më tej themelimin e "shtëpisë tonë 1", duke rritur kapitalin. Edhe pse shitëm kapitalin tonë në Itali, sërish treguesit tonë financiarë u rritën, edhe nëse e krahasojmë ndërkombëtarisht, kapitali ynë u rrit me 250% në fund të 2017-ës.



Andreas Brandstetter
CEO, UNIQA Insurance Group
Kryetar, Bordi Mbikëqyrës i
SIGAL UNIQA

të primeve ne u rritëm përkatësisht me 4.9% në vitin 2017, jo më shumë nga çfarë prisnim, por gjithësesi më shumë sesa industria e sigurimeve në Europë.

E rritëm fitimin nga sigurimet e jetës në terma afatgjatë, edhe pse kushtet ku ndodheshim nuk na favorizonin, sepse shitëm aksionet tona në Itali dhe ndërpremë kapitalin

e bizneseve të tjera në Austri.

UNIQA numëroi një kapital prej 700 milionë eurosh në vitin 2017. Përgjatë viteve të ardhshme duam që të tregojmë më shumë kujdes në përdorimin e kapitalit, duke e investuar atë në mënyrë selektive, për pasojë parashikojmë që të kemi një rritje të qëndrueshme të të ardhurave.

Së dyti, ne po bëjmë progres të vazhdueshëm në pesë nismat tona të grupit, të cilat i prezantuam në mars të 2016-ës, nisma të cilat i përkisnin "katit të parë" të "shtëpisë tonë".

Nisur edhe nga situata ekonomike e rajonit ku ne operojmë, kërkesa për sigurime në këto rajone ka ardhur gjithmonë në rritje.

Së treti, falë edhe emrit shumë të mirë që ka UNIQA tek klientët tanë, ne kemi përfituar nga kjo në këto aspekte: në termat e volumit

Pavarësisht dëmit të lartë, ne kemi vazhduar ta zgjerojmë rrjetin e shitjeve të sigurimeve të pronës, sipas strategjisë që kishim planifikuar. Në 2017-ën, e gjithë industria e sigurimeve dhe risigurimeve u godit nga katastrofat natyrore, si pasojë e kësaj UNIQA humbi rreth 50 milionë euro më shumë sesa mesatarja e vitit të kaluar.

Megjithatë, ne patëm mundësi që të përmirësojmë më tej raportin e kombinuar në 97.5%, një hap inkurajues për rrugën tonë për të arritur në shifrën 95% në vitin 2020.

Linja e biznesit të sigurimeve shëndetësore ka performuar mirë me një nivel të lartë të përfitimit. Kur bëhet fjalë për sigurimin shëndetësor, fitojmë një diferencë tërheqëse para tatimit prej rreth 350 pikësh bazë në rezervat teknike.

Implementimi i Platformës së Sigurimeve UNIQA (Uniqa Insurance Platform, UIP) bën lidhjen ndërmjet kapitalit të lartë të pritshëm me burimet njerëzore. Projekti kërkon një përkujdes dhe kohë të veçantë, por aktualisht çdo gjë po shkon sipas planit. Prodhimi i produkteve tona të sigurimit të jetës për shitjet në bankë në Austri, që fillon në verë të 2018-ës, do të fillojnë të implementohen në një platformë të re.

Rregullimi i bizneseve tona kërkon gjithashtu zgjerim të burimeve të IT. Ne po implementojmë rregulla të reja të Bashkimit European, të tilla si udhëzimi i ri i shpërndarjes së sigurimeve IDD ose Rregullorja e Përgjithshme e Mbrojtjes së të Dhënave të BE-së, po me aq zell ashtu siç po përgatisim edhe rregullatorin e ri të konatibilitetit, IFRS 9 and 17, të

cilat do ti japin efektet në 2021. Ky projekt do ta na 'gjobisë' me më shumë se 30 milionë euro, shumë më shumë sesa na kushtoi fillimi i implementimit të projektit "Solvency II".

Në 'katin e dytë' të 'shtëpisë tonë', ku po ndërtojmë të ardhmen e kompanisë tonë përreth dixhitalizimit dhe inovacionit, po përmirësohemi gjithmonë e më shumë në përdorimin efektiv të burimeve tona. Në terma afat-shkurtër, ne duam të përmirësojmë dukshëm eksperiencat e klientëve sa i përket brand-it, jo vetëm për eksperiencën dixhitale

të konsumatorëve, por edhe në botën aktuale analoge. Në terma afat-gjatë ne po punojmë intensivisht për të ardhmen e katër ekosistemeve: Shëndeti, Lëvizshmëria, Shtëpitë e Zgjuara dhe në Menaxhimin e Riskut Financiar, ku po investojmë në zhvillime të reja nëpërmjet entitetit tonë të sipërmarrjes.

Së fundmi, zonja dhe zotërinj, dëshiroj të përsëris qëllimin tonë për të vazhduar të paguajmë dividendë më të lartë për çdo aksion në vit-jo larg thelbit të kompanisë, por në

bazë të të ardhurave në rritje të vazhdueshme, pozicionit tonë të kapitalit jashtëzakonisht të fortë dhe qëndrueshmërinë e rrjedhjes së parave.

**Ne u rritëm
përkatësisht me
4.9% në vitin 2017,
jo më shumë nga
çfarë prisnim,
por gjithësesi
më shumë sesa
industria e
sigurimeve në
Europë.**

Gjithashtu dua t'ju falënderoj në emër të të gjithë punonjësve për interesin që keni për kompaninë tonë. Ndryshimet revolucionare në industrinë e sigurimeve-interesi i ulët, zhvillimet teknologjike, modeli tranzit i biznesit, konkurrentët përçarës dhe nevojat gjithmonë e më ndryshim të klientëve,

e bëjnë industrinë tonë një nga më interesantet në botë për momentin.

Kolegët e mi dhe unë jemi më të lumtur se kurrë që punojmë për ju dhe shpresojmë që po japim një kontribut të vogël që, duke siguruar klientët tanë, dhe ju gjithashtu, bëjmë që të shijoni një jetë më të sigurtë, më të mirë dhe më të gjatë.

**Sinqerisht,
Andreas Brandstetter
CEO UNIQA Insurance Group AG**

Të nderuar klientë të SIGAL UNIQA, Të nderuar partnerë,

Si në çdo sektor tjetër, edhe në industrinë e sigurimeve, dixhitalizimi është kthyer në kryefjalë të biznesit. Si i tillë, ai po e orienton biznesin drejt një rryme të re, drejt shpejtësisë, thjeshtësisë dhe praktikitetit. Për këtë arsye, duke patur vizionin e qartë për nevojat dhe kërkesat e klientëve dhe duke qenë të hapur ndaj ndryshimeve që na dikton koha, skuadra e SIGAL UNIQA-s i



Avni Ponari
CEO i SIGAL UNIQA
Group Austria

ka paraprirë këtyre ndryshimeve, përmes përforsimit të dixhitalizimit dhe teknologjisë së informacionit. Në vitin 2016 ne filluam të investojmë dhe modernizojmë sistemin tonë të teknologjisë së informacionit dhe ishim e para kompani në Shqipëri që lançuan sigurimin online.

Sot që flasim, platforma e sigurimeve online të SIGAL UNIQA është e vetmja platformë e plotë në Shqipëri, ku mund të kryhet i gjithë procesi që nga marrja e informacioneve e deri tek blerja e policës së sigurimeve. SIGAL UNIQA aktualisht numëron 8 produkte sigurimesh që mund të blihen online, direkt nga celulari ose kompjuteri dhe synimi ynë është që të gjitha produktet e sigurimit të mund të blihen online në një të ardhme jo të largët.

Ky është një zhvillim tejet i rëndësishëm nisur nga fakti që jeta është bërë aq e shpejtë dhe e ngarkuar sa sot njerëzit kërkojnë të shkurtojnë sa më shumë procedurat burokratike nëpër zyra, të kursejnë kohën dhe të shkurtojnë shpenzimet.

Nisur nga kjo, SIGAL UNIQA po punon që së shpejti të hapë Zyrën e Asistencës për

të Dëmtuarit nga Aksidentet Automobilistike, ku klientët mund të marrin asistencë ligjore dhe të mund të shkurtojnë kohë dhe gjithë procedurat burokratike nëpër zyra dhe gjykata. Kjo zyrë do t'u mundësojë klientëve marrjen në kohë të shpejtë të dëmshpërblimit, evitimin e procedurave gjyqësore dhe marrjen e plotë të shumës së dëmshpërblimit.

Ne vazhdojmë të ruajmë pozitat tonë të liderit me 30% të tregut, pavarësisht numrit të kompanive që operojnë në treg dhe jemi një nga grupet financiare më të fuqishëm në rajon.

Kjo natyrisht që falë menaxhimit të mirë si dhe në sajë të rreth 1200 punonjësve dhe agentëve tanë në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni, falë punës të së cilëve kemi fituar

besimin e qindra-mijëra klientëve.

Ky sukses vjen edhe falë bashkëpunimit të shkëlqyer me partnerit tonë kyç UNIQA Insurance Group. Gjigandi austriak i sigurimeve, me një histori e përvojë 200-vjeçare në industrinë e sigurimeve në Europë, është një garanci e vyer jo vetëm për ne si SIGAL UNIQA, por edhe për gjithë tregun e sigurimeve në Shqipëri dhe rajon.

2017-ta ishte një vit i mirë për SIGAL UNIQA, dhe kam besimin që potencialin tonë do të vazhdojmë ta ruajmë edhe përgjatë viteve që do të vijmë.

Me vizion e ide të qarta, me staf të përkushtuar, me besimin e plotë nga klientët tanë dhe me

mbështetjen e fortë të partnerit tonë strategjik, jemi të bindur për rrugën që po ndjekim dhe i kemi të qartë objektivat që do të arrijmë.

Duke falënderuar përzemësisht secilin prej jush për besimin që na keni dhënë për gati 20 vite me radhë, kam bindjen se së bashku do të vazhdojmë të punojmë gjatë si një skuadër e madhe me një frymë të mirë!

Miqësisht,

Avni PONARI

Drejtore i Përgjithshëm, SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA

Anëtar, Bordi i Mbikëqyrjes SIGAL UNIQA

Ne vazhdojmë të ruajmë pozitat tonë të liderit me 30% të tregut, pavarësisht numrit të kompanive që operojnë në treg dhe jemi një nga grupet financiare më të fuqishëm në rajon.

UNIQA - NJE PREJ KOMPANIVE ME TE MEDHA TE SIGURIMEVE NE EUROPE


UNIQA Insurane Group është prezente në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni që prej vitit 2007, si aksioneri kryesor i SIGAL UNIQA.

UNIQA është një prej grupeve më të fuqishëm financiarë në Austri dhe në Europën Qendrore dhe Lindore.


Gjigandi i sigurimeve ka një histori mbi 200-vjeçare në tregun e sigurimeve dhe përbëhet nga rreth 20 mijë punonjës që iu shërbejnë mbi 9.5 milionë klientëve në 16 shtete.

Me 22% të tregut, UNIQA është kompania e dytë më e madhe në Austri. Aktiviteti i grupit UNIQA është i shtrirë në 16 shtete të Europës Qendrore-Lindore, ku operon përmes 40 kompanive sigurimi.

% sipas produkteve



...në tregun në Austri dhe Europën Qendrore dhe Lindore



Mendo



Bordi Mbikëqyrës SIGAL UNIQA Group Austria



Andreas Brandstetter
Kryetar i Bordit Mbikëqyrës, SIGAL UNIQA
CEO i UNIQA Insurance Group



Erhard Busek
Zv. Kryetar i Bordit
Mbikëqyrës, SIGAL UNIQA



Wolfgang Kindl
Anëtar i Bordit Mbikëqyrës,
SIGAL UNIQA
CEO i UNIQA International



Gerald Mueller
Anëtar i Bordit Mbikëqyrës,
SIGAL UNIQA



Alexander Breit
Anëtar i Bordit Mbikëqyrës,
SIGAL UNIQA



Vinzenz Benedikt
Anëtar i Bordit Mbikëqyrës,
SIGAL UNIQA



Martin MATA
Anëtar i Bordit Mbikëqyrës,
SIGAL UNIQA

VLERAT DHE PARIMET TONA

1.

Ne frymëzojmë

Fokusoheми tek klienti
Rekrutojmë dhe trajnojmë
Jemi të vëmendshëm ndaj kërkesave

Ne jemi të përkushtuar ndaj klientëve dhe partnerëve tanë. Ne interesohemi për klientët dhe jemi të devotshëm ndaj tyre. Ne kemi predispozitën ti njohim ata nga afër, të kuptojmë nevojat e tyre dhe ti frymëzojmë ata. Si një grup solid ne gjithmonë përpiqemi që të mbështesim dhe motivojmë kolegët tanë.

3.

Ne jemi të hapur

Jemi të besueshëm dhe me integritet
Jemi lider të tregut
Jemi të drejtpërdrejtë

Ne jemi të ndershëm dhe të drejtpërdrejtë. Veprimet tona brenda kompanisë si dhe me palët e tjera janë të hapura dhe transparente. Ne u besojmë klientëve tanë dhe kolegëve, ndaj dhe shërbimi që ofrojmë është i besueshëm. Nuk ka asnjë axhendë të fshehur, gjithçka është transparente.

2.

Ne formësojmë

Ofrojmë zgjidhje optimale
Mundësojmë plane afatgjata
Njohim tendencat e tregut


Ne zhvillohemi vazhdimisht. Jemi aktivë, të hapur për ide të reja dhe për të implementuar standarte të reja në sektorin e sigurimeve me zgjidhje të reja inteligjente. Si skuadër ne i zhvillojmë fuqitë tona dhe jemi gjithmonë të gatshëm për të mësuar dhe për t'u rritur profesionalisht.

4.

Ne servirim

Fokusoheми tek rezultatet
Jemi të përkushtuar
Ndërtojmë strategji efikase


Ne duam të jemi të suksesshëm. Si SIGAL UNIQA, qëllimi ynë kryesor është që të jemi gjithmonë të parët, gjithmonë lider të tregut. Ne jemi të suksesshëm sepse u ofrojmë klientëve tanë shërbimin më të mirë dhe të pakrahasueshëm. Ne gjithmonë i mbajmë premtimet ndaj klientëve dhe ndaj njëri-tjetrit.



Aksionerët tanë

13.1%

Investitorë
Vendas



86.9%

UNIQA Insurance Group

NGJARJE TË RËNDËSISHME

SIGAL & UNIQA 10 vjet bashkëpunim

Kompania më e madhe e sigurimeve në Shqipëri, SIGAL UNIQA Group AUSTRIA, shënoi 10-vjetorin e futjes në tregun shqiptar të sigurimeve të një prej kompanive lider në Europën Qendro-Lindore, UNIQA Insurance Group. Në vitin 2007 UNIQA vendosi të blejë një pjesë të aksioneve të SIGAL, duke u kthyer kështu në një partner kyç për SIGAL, por edhe një faktor i rëndësishëm për tregun e sigurimeve në Shqipëri dhe rajon.

SIGAL gëzon meritën për futjen në tregun shqiptar të sigurimeve të të parit investitor strategjik european, me një potencial të jashtëzakonshëm dhe me një eksperiencë mbi 200-vjeçare në fushën e sigurimeve. Futja e UNIQA-s në industrinë e sigurimeve në Shqipëri ka qenë jo vetëm një garanci për tregun shqiptar, por edhe një indikator që ka luajtur një rol të rëndësishëm në rritjen dhe përmirësimin e tregut tonë të sigurimeve dhe në ndryshimin e opinionit publik për shoqëritë e sigurimeve, sikundër ka ndikuar jo pak edhe në ekonominë shqiptare.

“Ne jemi të lumtur që UNIQA na besoi në 10 vite më parë, për të investuar në tregun e sigurimeve vendas përmes kompanisë



Konferenca për shtyp “10 vjet pjesë e UNIQA- Një histori suksesi”
Nga e majta: Wolfgang Kindl, CEO i UNIQA International
Avni Ponari, CEO i SIGAL UNIQA Group Austria
SH.T.Z. Johann Sattler, Ambasadori i Austrisë

**I pari
investitor
strategjik
european në
industrinë e
sigurimeve**

tonë SIGAL, dhe sot e them me bindje dhe krenarisht që kjo ka qenë një nga vendimet më të mira që unë kam marrë në fushën e biznesit. Sepse të bashkëpunosh me një kompani si UNIQA Insurance Group është jo vetëm një siguri dhe sukses për ne si kompani, për SIGAL-in, por edhe një vlerë e shtuar, një aset tejet me vlerë për të gjithë tregun tonë dhe një impuls shumë i mirë për ekonominë e Shqipërisë, sikundër është një garanci financiare e rëndësishme për investitorët vendas dhe të huaj.

Të qenit gjithmonë korrekt dhe pranë klientëve, të qenit inovator në krijimin e produkteve të dobishme dhe sipas nevojave e kërkesave të klientëve, na ka bërë ne të suksesshëm dhe të jemi gjithmonë lider në këtë industri dhe një hap përpara konkurrentëve tanë.

Po përpiqemi ti bëjmë sigurimet pjesë të jetës dhe të kulturës së shqiptarëve si një domosdoshmëri për një jetë më të qetë. Ne po përpiqemi për të forcuar dinjitetin njerëzor dhe pavarësinë individuale të qytetarëve nga shteti dhe strukturat e tij”, -tha ndër të tjera, CEO i SIGAL UNIQA Group AUSTRIA për Shqipërinë, Kosovën dhe Maqedoninë, Z. Avni PONARI.

Nga ana e tij, CEO i UNIQA International, Z. Wolfgang KINDL tha se kompania që

ai përfaqëson e ka në prioritet Shqipërinë, Kosovën dhe Maqedoninë dhe do të vazhdojë të investojë në tregjet e këtyre shteteve.

Në këtë takim morën pjesë gjithashtu personalitetet më të larta të ekonomisë dhe financave në Shqipëri, Ambasadori i Austrisë në Shqipëri, SH. T.Z. Johann Sattler si dhe përfaqësues të institucioneve dhe bizneseve austriake në Shqipëri e shumë drejtuesë e personalitete të tjera shqiptarë dhe të huaj.



40 përfaqësuesë të UNIQA-s zhvilluan takimin vjetor në Shqipëri

Takimi ndërkombëtar i UNIQA solli rreth 40 drejtues të marketingut dhe medias nga kompanitë UNIQA në Europë.

“Mendo skuadrën, ndërto të ardhmen”. Ky ishte slogani i takimit vjetor të 40 drejtuesve të Marketingut dhe të Marrëdhënieve me Publikun të kompanive UNIQA nga 18 shtete të Europës.

Për herë të parë ky takim u zhvillua në Shqipëri për 4 ditë me radhë, ku pjesëmarrësit, përveç shkëmbimit të eksperiencave të ndryshme dhe diskutimit mbi idetë dhe projektet e reja që do të implementohen sa i përket marketimit të brand-it UNIQA dhe të produkteve të sigurimit, patën mundësinë që të vizitojnë Tiranën dhe Durrësin, të njihen me historinë dhe kulturën e vendit

tonë, të shijojnë ushqimet tradicionale shqiptare, të mrekullohen nga një pjesë e vogël e detit Adriatik dhe të marrin shumë kujtime e mbresa të paharrueshme nga Shqipëria për ti përcjellë në vendet e tyre.

Një vizitë e veçantë iu rezervua edhe në zyrat qendrore të SIGAL UNIQA, ku u mikpritën nga Drejtori i Përgjithshëm Z. Avni Ponari dhe nga drejtuesit e tjerë të kompanisë, si dhe patën mundësinë që të vizitojnë “Muzeun SIGAL”, i cili është hapur së fundmi dhe që është një dëshmi e të gjithë rrugëtimit të SIGAL që prej fillimit e deri më tani.



Konferenca Vjetore e grupit SIGAL UNIQA Shqipëri-Kosovë-Maqedoni

Konferenca vjetore e grupit SIGAL UNIQA u zhvillua këtë vit në Tiranë, Shqipëri, në ambientet e Hotel Tirana.

Në takim morën pjesë drejtuesit e kompanisë dhe drejtorët nga të gjithë departamentet e kompanive SIGAL UNIQA nga të tre shtetet Shqipëri-Kosovë-Maqedoni dhe u diskutua

Mbi 1200 punonjës dhe agentë në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni

mbi të dhënat financiare të vitit 2017, objektivat që ishin përcaktuar që në fillim të vitit dhe se sa ishin realizuar këto objektiva për secilin shtet dhe secilën degë të veçantë.

Në vëmendje u vunë e ardhmja dixhitale e kompanisë si dhe promovimi i kompanisë në tërësi dhe produkteve në veçanti.

Çelet muzeu sigurimeve në SIGAL UNIQA, i pari në llojin e tij në rajon

U hap për herë të parë muzeu i sigurimeve në ambientet e zyrave qendrore të kompanisë SIGAL UNIQA Group AUSTRIA.

Ky muze, i cili paraqet të gjithë historinë e SIGAL që nga themelimi në vitin 1999 e deri më sot, është i pari në llojin e vet jo vetëm në Shqipëri por në të gjithë rajonin.

Në muze gjenden fakte historike, fotografi të drejtuesve dhe stafit e punës ndër vite, objekte dhe polica të vjetra dhe çdo gjë tjetër që indentifikon SIGAL dhe historikun e tij të sigurimeve për gati dy dekada.



Historiku i tregut të sigurimeve tashmë në një muze

VLERESIME NDERKOMBETARE

Oda e Maqedonisë vlerëson UNIQA-n

Biznesi është kontribuesi kyç në ekonominë e një vendi dhe këtë gjë ka bërë edhe UNIQA në ekonominë e Maqedonisë. Për kontributin dhe vlerat e saj, UNIQA Shkup, (pjesë e grupit rajonal SIGAL UNIQA Group Austria) u vlerësua si një nga 100 kompanitë më të mira në Maqedoni nga Oda Ekonomike Veri-Perëndimore e Maqedonisë.

Në ceremoninë e mbajtur në Shkup, me pjesëmarrjen e Kryeministrit Zaev dhe Kryetarit të Parlamentit Z. Xhaferri, CEO i SIGAL UNIQA, Z. Avni Ponari, gjatë fjalës së tij, kërkoi më tepër vëmendje të shtetit për biznesin.

SeeNews

SeeNews, i cili studion tregjet financiare Europiane, rendit SIGAL UNIQA në vendin e 54 nga 100 kompanitë më të mëdha të sigurimeve në Europën Juglindore.

Referuar raportit të SeeNews për “TOP 100 INSURERS” SIGAL UNIQA renditet e para nga kompanitë e sigurimit në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni.

Monitor

SIGAL UNIQA renditet në 50 kompanitë më të mëdha në Shqipëri. Renditja është bërë në bazë të të ardhurave vjetore, ku SIGAL UNIQA rezulton me 7 vende rritje në krahasim me 1 vit më parë.

XPRIMM

XPRIMM, institucioni më i madh i të dhënave mbi industrinë e sigurimeve për Europën Qendrore-Lindore, raporton të dhënat e tregjeve të sigurimeve për të gjithë rajonin për vitin 2017.

Nga të dhënat për tregun në Shqipëri, SIGAL UNIQA Group AUSTRIA kryeson tregun e sigurimeve në të dy sektorët: Jetë dhe Jo-Jetë, përkatësisht me 63% të tregut të Jetës dhe 29% të tregut të Jo-Jetës.

SIGAL UNIQA kryeson tregun e sigurimeve në Shqipëri që prej vitit 2002, në prime, cilësi, produkte inovatore dhe korrektësi.





UNIQA Insurance Group
Vjenë, Austri

PËRGJEGJËSIA SOCIALE



Jemi të binsur që investimi në art dhe kulturë është një prej investimeve më të mira që çdo kompani mund të bëjë për të ardhmen.

Orkestra e Klubit të Artit SIGAL koncert në Valbonë

Orkestra e Klubit të Artit dhe Kulturës SIGAL ishte për herë të parë në Valbonë.

Grupi i artistëve të shkëlqyer performoi përpara publikut të Valbonës dhe turistëve që ndodheshin atje pjesë nga repertori më i njohur shqiptar dhe botëror, nën dirigjimin e Meshtit të Madh, Ermir Dizdari.

Të dëgjosh mes alpeve mrekullinë e një orkestre harqesh, kjo nuk kishte ndodhur kurrë më parë. Një emocion i pazakontë që për herë të parë kanë shijuar turistët në Valbonë.

Nuk kishte ndodhur asnjëherë më parë që në parkun më të vizituar të Shqiptarëve të sillej një orkestër e përmasave të tilla.

Kjo nismë u bë e mundur nga SIGAL UNIQA Group Austria.

Orkestra e Klubit të Artit SIGAL që prej themelimit të saj ka zhvilluar koncerte të shumta në shumë zona dhe qytete të Shqipërisë, ku përveç publikut shqiptar, artin e bukur të

orkestrës e kanë shijuar edhe turistë të shumtë, si në Parkun Kombëtar të Butrintit, në qytetin e Durrësit, në Shkodër, Pogradec, Elbasan, Tiranë, Valbonë etj.

“Vienna salutes to Tirana” - Ajka e artistëve shqiptarë në zemër të Vjenës

“Vienna salutes to Tirana” është koncerti që u zhvillua me zërat e mrekullueshëm të artistëve shqiptarë dhe austriakë, me rastin e 105-Vjetorit të Shtetit Shqiptar.

Me mbështetjen e SIGAL UNIQA Group Austria, sopranoja me famë botërore Inva Mula, balerini i shkëlqyer Eno Peçi, violinisti Olen Çezari, baritoni Gëzim Myshketa dhe pianisti Genc Tukiçi janë disa nga artistët shqiptarë me famë botërore që u ngjiten në skenën e “Konzerthaus Wien”, në sallën Mozart, duke përcjellë emocione të jashtëzakonshme për të gjithë të pranishmit.

Ajka e artistëve shqiptarë, të shoqëruar nga Volkhard Steude, Kuarteti i Filarmonisë Vjeneze



dhe Maria Yakovleva, primabalerina e Operës Shtetërore të Vjenës, performuan pjesë nga autorët më të mirë të muzikës botërore dhe shqiptare.

Ky koncert u bë i mundur nga kompania shqiptaro-austriake SIGAL UNIQA Group AUSTRIA dhe mbahet në kuadër të përvjetorit të 105-të të themelimit të Shtetit Shqiptar.

Rreth 9 vjet më parë, sopranoja me famë botërore Inva Mula, solli emocione të jashtëzakonshme në Mbrëmjen Gala të 10-Vjetorit të SIGAL UNIQA në Teatrin e Operas dhe Baletit në Tiranë dhe vetëm tre vjet më parë, në 2014, sërish SIGAL UNIQA ngjiti në skenë balerinin e rrallë shqiptar Eno Peçi për të performuar për publikun vendas.

Promovimi i artit, kulturës, sportit, artistëve dhe sportistëve shqiptarë dhe promovimi i Shqipërisë në arenat ndërkombëtare është një mision i kompanisë më të madhe të sigurimeve në Shqipëri, SIGAL UNIQA, e cila përveç të të bërit biznes në industrinë e sigurimeve, ka kontribuar vazhdimisht që prej themelimit të saj më 1999 në promovimin dhe zhvillimin e vlerave të Shqipërisë dhe Shqiptarëve.

SIGAL UNIQA mbështet ekspozitën me kryeveprat e artit modern italian

Kryeveprat e artit italian të viteve 1900 janë sjellë në Shqipëri për publikun vendas. Kjo është një prej ekspozitave më të mëdha të çelura ndonjëherë në Shqipëri ku spikasin figurat femërore, portrete të personazheve të famshme, pamjet e qytetit të përjetshëm dhe të fshatit romak e shumë vepra të tjera të punuara me mjeshtëri.

Giacomo Balla, Carlo Carrà, Giorgio de Chirico, Fortunato Depero, Renato Guttuso, Giacomo Manzù, Tato, Giulio Turcato, janë vetëm disa prej 60 artistëve, veprat e të cilëve tashmë kanë zënë vend në galeri.

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA mbështet këtë ekspozitë dhe do ti mbështesë nisma të tilla të cilat janë në të mirë të komunitetit.

Që prej themelimit të saj, SIGAL UNIQA ka mbështetur vazhdimisht artin dhe kulturën në Shqipëri si dhe ka kontribuar në ruajtjen e trashëgimisë kulturore të vendit tonë



Balkan Film & Food Festival u mbështet nga SIGAL UNIQA

SIGAL UNIQA mbështeti Balkan Film & Food Festival, i cili u zhvillua përgjatë datave 3-8 korrik 2017, në qytetin e Pogradecit.

Përgjatë këtij festivali u projektuan 64 filma të autorëve të ndryshëm nga të gjitha vendet e

Ballkanit.

Filma shqiptarë në këtë edicion ishin 19, nga të cilët 8 ishin prodhime të kineastëve shqiptarë dhe 11 të kineastëve të Kosovës.

Dashamirësit e kinematografisë patën mundësinë që ti ndjekin filmat në kinemanë "Mitrush Kuteli" në qendër të qytetit të Pogradecit, ndërsa për publikun e gjerë të gjithë filmat u projektuan edhe jashtë kinemasë.

Duke e vlerësuar maksimalisht artin dhe kulturën e vendit tonë, SIGAL UNIQA është promotore dhe mbështetëse e shumë aktiviteteve të llojeve të ndryshme.

Ekspozitë e rrallë në Bajram Curri

Shqipëria e viteve '90? Si ka qenë? Çfarë misteresh mbart? Ndryshimet rrënjësore që pësoi jeta e shqiptarëve; Ngarkesa historike e psiko-sociale e një kombi të çliruar nga kthetrat e regjimit më të egër që kishte njohur e përjetuar deri në atë kohë vendi ynë; Qytetarë të përvuajtur, familje në skamje, lëngimet e jetës së përditshme, por edhe dritëhije gati-gati të padukshme të grimcave të lumturisë të së përditshmes janë vetëm një pjesë e përshkrimit të historisë dhe të jetës së shqiptarëve që na e risjell në vëmendje, nëpërmjet fotografive reale e të gjalla, historiani, antropologu dhe fotografi i mirënjohur austriak Robert Pichler.

Më 14 korrik 2017, u zhvillua inaugurimi i ekspozitës së parë të kësaj natyre, "Shqipëria e viteve '90", dhe qëndroi e hapur deri më 10 shtator, në ambientet e Muzeut Historik në Bajram Curri, Tropojë.

Kjo ekspozitë u realizua falë mbështetjes së SIGAL UNIQA Group AUSTRIA dhe kujdesit të veçantë të vetë Drejtorit të Përgjithshëm, Z. Avni Ponari.

SIGAL UNIQA mbështet "Different Trains Festival"

Për të disatin vit radhazi, SIGAL UNIQA



mbështeti "Different Trains Festival".

Kryeveprat e Mozart, Sibelius, Schumann dhe Schubert u luajtën nga artistë të talentuar shqiptarë dhe të huaj, përgjatë tre ditëve, më 16, 22 dhe 27 shkurt 2017, në sallën e Akademisë së Arteve dhe në sallën e Kishës Ortodokse.

SIGAL UNIQA është mbështetësi kryesor i këtij eventi artistik të veçantë dhe do të vazhdojë të mbështesë artin e kulturën, sikundër ka bërë përgjatë gjithë viteve të veprimtarisë së saj.

"Një ekspozitë dhe hapësirë reklamimi"

Kjo ishte kërkesa e artistes Afërdita Cakaj për punimet e saj të rralla artizanale, kërkesë të cilën e bëri publike në emisionin "Do you have an Idea" në Vizion +, ku Drejtori i Përgjithshëm i SIGAL UNIQA ishte pjesë e jurisë. Kjo kërkesë gjeti mbështetjen e menjëhershme nga Z. Ponari dhe dëshira e artistes u bë realitet, duke i vënë asaj në dispozicion ambientet e Klubit të Artit dhe Kulturës për të realizuar ekspozitën, si dhe mjete të tjera të nevojshme.

Pikturat me qëndisje dhe arti i saj i veçantë u ekspozuan tek Klubi i Artit dhe Kulturës SIGAL Durrës nga datat 8-16 prill.

Klinika Lëvizëse vijon turin në zonat rurale në Shqipëri

Klinika Lëvizëse SIGAL UNIQA gjatë vitit 2017 vijoi turin e saj në zonat e Shkodër, Beratit, Fushë Arrësit, Kamzës, Selcës (Kelmend), Dushaj (Tropojë) dhe Çorovodë. Stafi i kualifikuar i klinikës me në krye Doktor Panaritin, iu gjendën pranë banorëve të këtyre zonave duke ofruar ekzaminime dhe konsulta falas pranë klinikës lëvizëse SIGAL UNIQA.

Në klinikën lëvizëse mund të kryhen ekzaminime të tilla si: Vizitë dhe konsulta me mjek patolog, matje e sheqerit në gjak, ekzaminimin e gjendjes fitness (pesha, gjatësia, tensioni, balanca) elektrograma të zemrës, ECHO abdominale, ECHO e indeve të buta, ECHO e artikulacioneve, vizitë ORL, etj. Mendo është më mirë të parandalosh një sëmundje sesa ta kurosh atë!

SIGAL UNIQA mbështet kampionin e Europës në atletikë, Izmir Smajlaj

Smajlaj u shpall kampion Europe në kërcim për së larti në garat e zhvilluara në Beograd, ku ngriti flamurin shqiptar si kampion i vendit të parë.

Smajlaj theu rekordin kombëtar me kërcimin e tij 8.08 dhe SIGAL UNIQA është krenare që mbështet talente të tilla dhe do të vazhdojë të kontribuojë për sportin, artin dhe kulturën e vendit tonë.

Bienalja e Artistëve të Mesdheut pati mbështetjen e SIGAL UNIQA

SIGAL UNIQA mbështeti Ekspozitën e Artistëve të Rinj nga Mesdheu, e cila zhvillohet një



herë në dy vjet në një vend të ndryshëm të Europës.

Këtë vit (2017) kjo ekspozitë, ku morën pjesë 230 artistë nga 18 shtete të ndryshme europiane, u mbajt në Tiranë dhe Durrës, nga datat 5-9 maj.

Me qindra artistë të zhanreve të ndryshme, artet pamore, artet e aplikuara, muzika, filmi etj, u prezantuan me punimet e tyre, ku secila sillte nga një pjesëz të historisë e kulturës së vendit që ata përfaqësojnë.

SIGAL UNIQA është krenare që mbështet evente të përmasave të tilla dhe me një vizualitet të jashtëzakonshëm.

SIGAL UNIQA mbështet "MOTO FEST 2017" Sigal Uniq mbështeti sërish këtë vit Enduro Albania, MOTO FEST 2017.

Që prej themelimit të saj, SIGAL UNIQA ka mbështetur sportin, artin dhe kulturën, duke e vlerësuar maksimalisht dhe dhënë kontribut për zhvillimin dhe promovimin e këtyre fushave.

Edhe "MOTO FEST 2017", një lloj sporti i veçantë për Shqipërinë dhe që vitet e fundit po gjen zhvillim, pati mbështetjen e kompanisë më të madhe në vend, SIGAL UNIQA Group AUSTRIA.

INOVACION

Tashmë më shumë fleksibilitet në pagesë dhe rrjet më i gjerë partnerësh!

Sigurimi i nxënësve dhe studentëve online

Në faqen online të shitjeve të SIGAL UNIQA është shtuar edhe produkti i sigurimit të nxënësve dhe studentëve.

Tashmë çdo nxënës apo student do të ketë mundësi të futet online për të përlogaritur vetë primin e sigurimit që i duhet. Për studentët që do të shkojnë me studime jashtë Shqipërisë ky sigurim është i detyruar.

Në faqen online të SIGAL UNIQA ata do të mund të marrin të gjitha informacionet që ju duhen për këtë sigurim, të përlogarisin vlerën dhe më pas duhet të paraqiten pranë zyrave të SIGAL UNIQA për tu pajisur me siguracionin.

Mendo sa e thjeshtë është të sigurohesh online!

GPS Tracking nga SIGAL UNIQA në bashkëpunim me Telekom

SIGAL UNIQA në bashkëpunim me Telekom Albania bën të mundur gjurmimin e automjeteve nëpërmjet sistemit GPS.

Shërbimi GPS i ofruar nga SIGAL UNIQA në bashkëpunim me Telekom Albania ju mundëson të shikoni në çdo moment se ku ndodhet mjeti juaj, rrugën e përshkruar, shpjetësinë e lëvizjes së mjetit. Mjetet e gjurmuara përfshijnë makina, minibus, autobuzë, kamionë, trailer/automjete frigoriferë, motoçikleta, ambulanca, zjarrëfikese dhe çdo mjet tjetër pune.

Shërbimet GPS Tracking janë shumë të rëndësishme për të gjithë kompanitë, jo vetëm për të mësuar vendndodhjen e mjetit, por dhe për rritjen e efikasitetit të operimit të tyre.

Shëndeti në Udhëtim ofrohet falas me klientë Roaming të Vodafone

Eshtë finalizuar marrëveshja ndërmjet SIGAL UNIQA Group AUSTRIA dhe Vodafone Albania, për shitjen e policave të sigurimit të Shëndetit në Udhëtim nga celulari nëpërmjet Vodafone.

Të gjithë klientët e Vodafone Albania që aktivizojnë Roaming përfitojnë Shëndet në Udhëtim falas. Vodafone ka filluar të promovojë këtë produkt që ua ofron klientëve të saj nëpërmjet SIGAL UNIQA. Duket që kjo ide dhe mënyrë e re po përqafohet nga klientët, pasi shumë prej tyre kanë përfituar nga ky shërbim dhe numri është në rritje të vazhdueshme.

Fleksibilitet në pagesën e sigurimit

Që prej muajit gusht 2017 të gjithë klientët e SIGAL UNIQA kanë mundësinë të paguajnë me këste siguracionet që ju nevojiten.

SIGAL UNIQA në bashkëpunim me institucionin financiar luteCredit mundëson blerjen më këste të policave të sigurimit. Tanimë klientët e SIGAL UNIQA kanë mundësinë të paguajnë me këste siguracionet e detyrueshme dhe ato vullnetare.


Klientët mund të paraqiten pranë zyrave të SIGAL UNIQA për të marrë siguracionin që ju nevojitet, ndërsa pagesën mund ta shlyejnë me këste pranë luteCredit. Klientit i nevojitet vetëm karta e identitetit për të përfituar nga ky shërbim.

TREGU I SIGURIMEVE NË RAJON

SHQIPËRI

Tregu i sigurimeve jo-jetë


Tregu i sigurimeve të jo-jetës, në të cilin operojnë 8 kompani, u udhëhoq nga SIGAL UNIQA e cila zotëroi 27.41% të tregut. SIGAL UNIQA renditet gjithashtu e para edhe për pagesën e dëmeve duke paguar 23.21% të dëmeve.



Tregu i sigurimeve të jetës

Që prej disa vjetësh, në tregun shqiptar të sigurimeve të jetës operojnë 3 kompani sigurimi. Edhe për vitin 2017 tregu u udhëhoq nga SIGAL Life UNIQA me 59.96% e cila ka paguar 49.7% të dëmeve të ndodhura në treg.


SIGAL Life UNIQA 59.96%



Tregu i pensioneve private


Gjatë vitit 2017, në tregun e pensioneve operuan 3 fonde pensionesh private. Fondi i Pensioneve SIGAL udhëhoqi tregun si për vlerën e aseteve neto (51%) ashtu edhe për numrin e kuotave.

Fondi i Pensioneve SIGAL 51%




KOSOVË**Tregu i sigurimeve jo-jetë**


Në tregun kosovar operojnë 12 kompani sigurimi ndër të cilat SIGAL UNIQA Kosova renditet e dyta me 11.26% të tregut për volumin e primeve si dhe ka paguar 8.57% të dëmeve totale të tregut.

**Tregu i sigurimeve të jetës**


Në tregun kosovar të sigurimeve të jetës operojnë 3 kompani ndër të cilat SIGAL Life UNIQA Kosova renditet e dyta me 29.18% të tregut për volumin e primeve dhe ka paguar 2.79 % të dëmeve.

**MAQEDONI****Tregu i sigurimeve jo-jetë**

Në tregun maqedonas të sigurimeve të jo-jetës operojnë 11 kompani. UNIQA a.d. u rendit në vendin e gjashtë për nga volumi i primeve të shkruara (9.2%).

**Tregu i sigurimeve të jetës**


UNIQA Life renditet e katërta në tregun maqedonas të sigurimeve të jetës (6%) në të cilin operojnë 4 kompani.



TË DHËNA FINANCIARE


Grupi SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA

Prime të shkruara për katër vitet e fundit (në euro)



Kompania	2014 (në Euro)	2015 (në Euro)	2016 (në Euro)	2017 (në Euro)
SIGAL UNIQA AL Jo-Jetë dhe Risigurime	21,976,027	26,826,453	29,193,000	29,664,042
SIGAL Life UNIQA AL	4,724,770	4,821,793	4,249,000	5,476,588
SH.A.F.P SIGAL Life UNIQA	788,946	1,269,642	1,681,000	1,461,529
SIGAL UNIQA KS Jo-Jetë	12,390,804	12,482,576	10,501,000	9,559,338
SIGAL Life UNIQA KS	338,738	910,595	762,000	636,650
UNIQA MK Jo-Jetë	10,216,259	11,063,068	11,323,000	11,345,015
UNIQA Life MK	760,249	961,656	1,170,000	1,405,624
GRUPI	51,195,794	58,335,782	58,879,000	59,548,838

Prime të shkruara sipas produkteve për vitin 2017



Lloji i Produktit	AL (në Euro)	KS (në Euro)	MK (në Euro)	Grupi (në Euro)
Pasuri	8,767,400	1,566,940	2,832,733	13,167,073
Motorike	17,336,908	6,143,242	7,602,924	31,083,075
Jetë, Shëndet dhe Aksidente	8,430,758	2,845,856	2,314,982	13,231,596
Pensione Vullnetare*	1,461,529	-	-	1,461,529
Risigurime*	605,564	-	-	605,564
TOTALI	36,602,160	10,196,038	12,750,639	59,548,838

* Produktet e Pensioneve vullnetare dhe Risigurimet ofrohen vetëm në Shqipëri përkatësisht nga kompanitë SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Risigurime dhe SH.A.F.P SIGAL Life UNIQA.

RAPORTI I AUDITUESVE TE PAVARUR

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA sh.a.

Pasqyrat Financiare të Konsoliduara sipas
Standarteve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar
per vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

Raporti i Audituesve të Pavarur

Për Bordin e Drejtorëve dhe drejtimin e Sigal Uniq Group Austria sh.a.

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare e konsoliduara të Sigal Uniq Group Austria sh.a. dhe të filialeve të saja ("Grupi"), të cilat përfshijnë pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar më 31 dhjetor 2017, pasqyrën e konsoliduar të fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e konsoliduar të ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e konsoliduar të flukseve monetare për vitin e mbyllur në atë datë, si dhe shënimet për pasqyrat financiare të konsoliduara, përfshirë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe shënimeve të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të konsoliduara bashkëlidhur japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë të pozicionit financiar të konsoliduar të Grupit më 31 dhjetor 2017, si dhe të performancës së tij financiare të konsoliduar dhe flukseve të parasë të konsoliduar së tij për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesve për Auditimin e Pasqyrave Financiare të Konsoliduara.

Ne jemi të pavarur nga Grupi në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (Kodi i BSNEPK) dhe me Kodin e Etikës të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar në Shqipëri (Kodi i IEKA), si dhe me kërkesat etike të Ligjit Nr. 10091, datë 5 mars 2009, "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar", të ndryshuar, që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare të konsoliduara në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin e BSNEPK dhe Kodin e IEKA.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Çështje tjetër

Pasqyrat financiare të konsoliduara të Grupit të përgatitura në përputhje me SNRF për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016, kanë qenë audituar nga një auditues tjetër, i cili më datë 22 qershor 2017 ka shprehur një opinion pa rezervë mbi këto pasqyra financiare të konsoliduara.

Informacione të tjera

Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacionet e tjera përfshijnë informacionin që jepet në raportin vjetor të përgatitur nga drejtimi në përputhje me Nenin 128 të Ligjit nr. 52 " Për veprimtarinë e sigurimeve dhe risigurimeve", dhe përfshijnë pasqyrat financiare të konsoliduara dhe raportin tonë të audituesve mbi këto pasqyra. Raportin vjetor presim që ta kemi në dispozicion pas datës së këtij raporti të audituesve.

Opinionin ynë mbi pasqyrat financiare të konsoliduara nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione.

Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare të konsoliduara, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera, të identifikuar më lart kur t'i sigurojmë ato dhe të konsiderojmë nëse këto informacione të tjera kanë mospërputhje materiale me pasqyrat financiare të konsoliduara, apo me njohuritë që ne kemi marrë gjatë auditimit, ose nëse duket se ato kanë anomali materiale.

Pasi të lexojmë raportin vjetor, nëse arrijmë në përfundimin se në këtë raport ka një anomali materiale, atëherë ne duhet të komunikojmë për këtë çështje me ata që janë të ngarkuar me qeverisjen.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare të Konsoliduara

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të konsoliduara në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Grupit për të vazhduar në vijimësi, për të dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe për të përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likuadojë Grupin ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër. Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Grupit.

Përgjegjësitë e Audituesve për Auditimin e Pasqyrave Financiare të Konsoliduara

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare të konsoliduara në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë.

Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali mund të vijë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Grupit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Grupit për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare të konsoliduara, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Grupi të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare të konsoliduara, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare të konsoliduara paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Fatos Beqja
Auditues Ligjor



KPMG Albania Shpk
Blvd "Dëshmorët e Kombit"
Kullat Binjake, Kulla 1, Kati 13
Tiranë, Shqipëri

Tiranë, 29 maj 2018

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Sh.a.
Pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar më
(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lek)

	Shënime	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
AKTIVET			
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre	9	465,103	337,711
Depozita me afat	10	7,684,824	7,366,431
Investime në letra me vlerë	11	1,880,963	1,813,417
Llogari të arkëtueshme nga sigurimi dhe të arkëtueshme të tjera	12	1,215,850	1,053,813
Llogarit të arkëtueshme të risigurimit	13	1,361,828	1,263,993
Shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim	14	694,670	942,392
Aktive afatgjata materiale	15	1,192,559	1,259,676
Tatim fitimi i arkëtueshëm		38,627	-
Aktive të tjera	16	273,438	343,010
TOTALI AKTIVEVE		14,807,862	14,380,443
DETYRIMET			
Detyrimet për humbje dhe shpenzimet për rregullimin e humbjes	17	4,501,135	4,424,623
Rezerva të tjera	17	1,151,840	1,005,268
Rezervat për primin e pafitur	17	3,775,538	3,854,879
Detyrime të tatimit mbi fitimin		-	14,363
Detyrime nga sigurimet dhe risigurimet	18	651,358	590,398
Detyrime të tjera	19	311,473	252,489
TOTAL I DETYRIMEVE		10,391,344	10,142,020
KAPITALI			
Kapitali themeltar	20	2,232,909	2,232,909
Rezerva të tjera të kapitalit	20	52,133	52,133
Rezerva të rrezikut të sigurimit	21	579,595	568,313
Rezerva të konvertimit		(53,013)	32,294
Fitime të mbartura		1,589,987	1,342,372
Totali i kapitalit që i atribuohet pronarëve të shoqërisë mëmë		4,401,611	4,228,021
Interesi jo-kontrollues		14,907	10,402
TOTALI KAPITALIT		4,416,518	4,238,423
TOTALI KAPITALIT DHE DETYRIMEVE		14,807,862	14,380,443

Këto pasqyra financiare të konsoliduara janë aprovuar nga drejtuesit e grupit më 29 maj 2018 dhe janë firmosur nga:

Avni Popari
Drejtor i Përgjithshëm

Klement Mersini
Drejtor Finance

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Sh.a.**Pasqyra e konsoliduar e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse***(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lek)*

